



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 582/6 Prot.

Tiranë, më 19.02.2025

VENDIM

Nr. 14 Datë 19.02 2025

“PËR  
NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR 32 DATË  
30.06.2022 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" germa "ç" e pikës 3, të nenit 3, neni 6, pika 28, 29, 30, neni 49, në pikën 2 dhe 3 të nenit 58, pikës 3 të nenit 69, neni 79, pikës 5 të nenit 95, pikës 2 dhe 3 të nenit 109, pikës 1 dhe 2 të nenit 113, pikës 14/a, b, pikës 15/c të VKM nr.329 datë 12. 04. 2017 "Për trajtimin e veçantë të personelit akademik" në udhëzimin nr 7 datë 31.03.2021 të MAS për një ndryshim në Udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL" të nenit 43 të Statutit të UST-së, të Rregullores së UST-së, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 24 datë 13.02.2025 dhe nr. 31 datë 13.02.2025, në Relacionin e Administratorit nr 572 datë 17.02.2025 “ Për një ndryshim të Vendimit B.A nr.32 datë 30.06.2022, Bordi i Administrimit në mbledhjen e radhës,

V E N D O S I :

1. Të ndryshojë pikën 18.4 të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.32 datë 30.06.2022, si mëposhtë vijon:

**Ishte**

Të miratojë që kandidatët të cilëve ju është mbuluar pjesa e mbetur e tarifës prej 500.000 lek nga të ardhurat e institucionit, të përjashtohen nga përfitimi i granteve të tjera të ofruara nga të ardhurat e UST-së për periudhën e përfundimit të programit të ciklit të tretë

**Bëhet**

Të miratojë që kandidatët të cilëve ju është mbuluar pjesa e mbetur e tarifës prej 500.000 lek nga të ardhurat e institucionit, të përjashtohen nga përfitimi i granteve të tjera të ofruara nga të ardhurat e UST-së për periudhën e përfundimit të programit të ciklit të tretë, *kur kandidati është drejtues i Grupit të një projekti kërkimor dhe kur tema e kërkimit të këtij të fundit nuk lidhet me temën e Doktoratës" së kandidatit.*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori, FSHL, FVFR, FSHR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**

